

Sinjalizime

Ekskluzive | Këta janë të dyshuarit për sulmin me granatë në Podujevë – Policia bastis shtëpitë, sekuestron armë e municion



Sinjali.com

22 Korrik 2026 09:07



Katër muaj pas sulmit me granatë ndaj një shtëpie në fshatin Sfeqël të Podujevës, Policia e Kosovës ka zhvilluar një aksion të gjerë, duke bastisur shtëpitë e personave të dyshuar dhe duke sekuestruar armë, municion e pajisje të ndryshme ushtarake, raporton Sinjali.

Sinjali mëson ekskluzivisht se të dyshuarit në këtë rast janë Lavdim Zejnullahu-Parascan rreth 37 vjeç, Liridon Lushaku rreth 36 vjeç dhe Arif Zejnullahu rreth 26-vjeç, ndërsa viktimë e rastit është D. Sh.rreth 24 vjeç.

Sipas burimeve të Sinjalit, ngjarja kishte ndodhur më 11 mars 2026, kur ndaj shtëpisë së familjes Shaqiri në fshatin Sfeqël ishte hedhur një mjet shpërthyes që dyshohej të ishte granatë dore. Fillimisht rasti ishte iniciuar si *"Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm"*, por pas veprimeve hetimore dhe grumbullimit të provave, në koordinim me Prokurorin e Shtetit, është ricilësuar si *"Vrasje në tentativë"*, *"Shtytje"* dhe *"Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve"*.

Më 21 korrik, me urdhër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, hetuesit e Njesisë për Hetimin e Krimeve të Rënda, të asistuar nga Njësia Speciale Operative dhe njësia K9, kanë realizuar bastisje në dy lokacione në Podujevë.

Gjatë kontrollit në shtëpinë e Lavdim Zejnullahu-Parascan, Policia ka sekuestruar dy pistoleta (njëra e dyshuar armë me gaz), 67 fishekë të kalibrave të ndryshëm, tre karikatorë për pistoleta, tre karikatorë për armë të gjata, një gëzhjojë dhe pjesë të ndryshme armësh të gjata.



Lexo edhe

Ekskluzive | Sulmi me granatë në Podujevë, bastisen shtëpitë e të dyshuarve – gjenden armë e municion, dy



Ndërkohë, në shtëpinë e Liridon Lushakut është gjetur dhe sekuestruar një pistoletë, ndërsa ndaj tij është iniciuar një rast i veçantë për veprën penale *"Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve"*.

Arif Zejnullahu është intervistuar në lidhje me posedimin e paautorizuar të armëve dhe, me urdhër të Prokurorit, është liruar në procedurë të rregullt.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se Lavdim Zejnullahu-Parascan dhe Liridon Lushaku nuk janë gjetur në adresat e tyre gjatë aksionit. Të njëjtëve u janë lënë ftesa për paraqitje në Polici, ndërsa janë shpallur në kërkim policor.

Hetimet për rastin vazhdojnë.

Shënim: Personat e apostrofuat në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

kërkim

Podujevë

Policia

Sulm

Të tjera:



Policia e konfirmon për Sinjalin se polici 35-vjeçar dyshohet se ka kryer vetëvrasje

Siguri



Plagosje, përleshje dhe të shtëna me armë zjarri, policia arreston dy persona në Pejë

Siguri



Policia kërkon ndihmë nga qytetarët për kapjen e të dyshuarit për vjedhje

Siguri



Ekskluzive | Ky është i dyshuari që u paraqit pas dy javësh në arrati – Policia i kishte gjetur ...

Sinjalizime




Ekskluzive | Aksion i madh kundër evazionit fiskal në Prizren e Suharekë – zbulohen...

Sinjalizime




Ekskluzive | Të shtëna me kallashnikov në aheng familjar në Prizren – dy persona në prang...

Sinjalizime



Ekskluzive | Ky është zyrtari i arrestuar për lejimin e importit të kimikateve të ndaluara...

Sinjalizime



Gruaja e denoncoi për dhunë, Policia i gjen kallashnikov në shtëpi – 65-vjeçari procedohet...

Sinjalizime

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtimi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketbolli
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera